

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil**, në trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësi **Drilon HARAÇIA** - Kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve porotë **Xhavit Elezi** dhe **IsmetKëndusi** – anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike **Valbone Hoxha**, në çështjen juridiko-civile të propozueses **S(P)J** nga P. Republika e Gjermanisë, të cilin e përfaqëson **M.S** avokat nga Prishtina, me autorizim në lëndë dhe propozuesit **J(Z)Z**, nga fsh: H. Komuna Gjakovës, me bazë juridike zgjidhje e martesës me marrëveshje, në seancën kryesore jo publike, të mbajtur me **dt.23.02.2017** në prezencën e të autorizuarit të propozueses dhe propozuesit, mori këtë;

## **A K T G J Y K I M**

**I.ZGJIDHET** martesë me marrëveshje në mes të propozueses dhe propozuesit **S(P)J** nga P, Republika e Gjermanisë dhe propozuesit **J.Z** nga fsh.H,Komuna e Gjakovës, e lidhur me datën 05.11.2014, me numër rendor 61, me numër të referencës 2/2014RM/2009, të lëshuar me datën 06.11.2014 nga zyra e Gjendjes Civile në fsh.Skivjan, Komuna Gjakovës, në kuptim të nenit 68 pika 1, të Ligjit për Familjen i Kosovës.

**II.**Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## **A r s y e t i m**

Propozuesit pranë kësaj Gjykate kanë paraqitur propozimin për shkurorëzimin e martesës me marrëveshje, duke theksuar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë me dt.05.11.2014, pranë Zyrës së Gjendjes Civile në fsh.Skivjan, Komuna e Gjakovës. Në ndërkohëmarrëdhëniet e tyre janë përkeqësuar dhe kanë lind mos marrëveshje për shkak të botëkuptimeve të kundërta lidhur me mënyrën e jetesës. Si pasojë e kësaj ka ardhë deri të përkeqësimi i marrëdhënieve na atë masë, sa që jeta bashkëshortore është bërë e pa mundur, andaj edhe kanë ardhë në përfundim për shkëputjen e martesës së tyre me marrëveshje.

I autorizuari i propozueses në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbesë në tersi pranë propozimit për zgjidhjen e martesës, duke mbetur në tërësi pranë deklaramëve të dhëna në propozim. Po ashtu shton se fëmijë nuk kanë dhe as që presin në të ardhmen.I autorizuari i propozueses në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë propozimit dhe nga provat e administruara u vërtetua gjendja faktike, andaj propozoi Gjykatës që të aprovoi zgjidhjen e martesës me marrëveshje. Nuk kërkoi shpenzime procedurale dhe heki dorë nga drejta e ankesës në rast të aprovimit të propozimit.

Propozuesi gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë propozimit për zgjidhjen e martesës me marrëveshje si dhe pajtohet me deklaramet e lartcekura të autorizuarit të propozueses. I njëjti deklaroi se me propozuesen nuk jetojmë në bashkësi familjare.Propozuesi në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë propozimit të parashtruar me shkrim dhe thëniet në seancën e sodit. I propozoi Gjykatës që të aprovohet zgjidhja e martesës me marrëveshje.Shpenzimet procedurale nuk i kërkoi si dhe heki dorë nga drejta në ankesë, me rastin e aprovimit të zgjidhjes së martesës.

Gjykata në procedurën e provave ka bërë shikimin dhe leximin e Certifikatës së martesës së propozuesve me numër serik M01075212, me numër rendor 61, me numër të referencës 2/2014RM/2009 të lëshuar nga Zyra gjendjes civile në fshatin Skivjan, Komuna e Gjakovës me dt.06.11.2014, dhe pas vlerësimit të fakteve juridike – relevante të kësaj çështje, çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave të administruara, rrethanave jo kontestuese të palëve, në kuptim të nenit 8 të LPK, e miratoj propozimin për zgjidhjen e martesës me marrëveshje bazuar edhe në nenin 68 pika 1, të Ligjit për Familjen të Kosovës (Ligji nr.2004/32 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë” nr.4, të dt.01.09.2004, në tekstin e mëtejme LFK).

Nga provat e administruara u argumentua kjo gjendje faktike: nga Certifikata e martesës me numër serik M01075212, me numër rendor 61, me numër të referencës 2/2014RM/2009 të lëshuar nga Zyra gjendjes civile në fsh. Skivjan, Komuna Gjakovës me dt.06.11.2014, rezulton se palët-propozuesit kanë lidhur martesë me datën 05.11.2014, dhe nga kjo martesë nuk kanë pasur fëmijë.

Gjykata në rastin konkret konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 69 pika 1, 2 dhe 4 të LFK, sepse martesa e ka humbur qëllimin dhe efektin e vet për të cilin është lidhë. Është fakt se martesa lidhet në bazë të dashurisë, simpatisë, besnikërisë dhe vullnetit reciprok të bashkëshortëve. Mirëpo, meqë në rastin konkret këto elemente qenësore mungojnë, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit të para cituar, ku janë paraparë shkaqet e shkurorëzimit si shkaqe të përgjithshme dhe shkaqe të veçanta. Shkaqet e përgjithshme të shkurorëzimit të përcaktuara me nenin 69 par.1 të LFK, parasheh se bashkëshortet mund të e kërkojnë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme. Si shkaqe që sjellin çrregullimin serioze të marrëdhënieve bashkëshortore mund të jenë; xhelozia, mos përputhja e karaktereve dhe grindja e vazhdueshme. Ndërsa shkaqet e veçanta janë të parapara në nenin 69 par.2 të LFK, ku përcaktohen si; jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vepra penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike, sëmundja psikike e pa shërueshme etj. Pra, në rastin konkret kjo bashkësi martesore faktikisht ka pushuar së ekzistuari.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr konform nenit 449.1 lidhur me nenin 450 të LPK, dhe deklarimit të palëve në procedurë.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr.13/17 dt.23.02.2017**

**Kryetari i Trupi Gjykses,**  
**Gjykatësi**  
**Drilon HARAÇIA**

**UDHËZIM JURIDIK;** Ky Aktgjykim është i formës së prerë pasi që palët në procedurë kanë hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës.